

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"HD HOLDING SH.P.K".**

Në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) si dhe nenit 28 paragrafi 3 i Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"(i ndryshuar);

Sot më datë **12/02/2025**, themelohet shoqëria "HD HOLDING SH.P.K" (në vijimë Shoqëria) sipas kushteve të mëposhtme:

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1
DATA E THEMELIMIT, THEMELUESIT DHE EMRI SHOQËRISË**

1. Prej datës 12/02/2025, themelohet shoqëria "HD Holding" sh.p.k, e ndjekur në mënyrë të pandanshme nga shkurtimi "Sh.p.k", duke përcaktuar kështu formën ligjore të kësaj shoqërie holding si një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, e cila prej datës si më lart përshkruar, fillon prodhon efektet e saj juridike dhe i nënshtrohet të drejtës shqiptare lidhur me parashikimet ligjore mbi krijimin, funksionimin dhe përfundimin e saj.
2. Themeluesit e kësaj shoqërie janë:
 - **Z. Drilon Gashi**, shtetas Kosovar, i ditëlindjes 17/06/1983, lindur në Kosovë dhe banues në Kopliq i Poshtëm, Skënderaj, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Nr.Personal : 1003973561 dhe Nr I kartës ID : ID1931956.
 - **Z. Hazir Gashi**, shtetas Kosovar, i ditëlindjes 01/01/1988, lindur në Kosovë dhe banues në Kopliq i Poshtëm, Skënderaj, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Nr.Personal : 1251809212 dhe Nr I kartës ID : ID1033049.

**NENI 2
FORMA E SHOQËRISË DHE BAZA LIGJORE**

1. Shoqëria "HD Holding" sh.p.k është një entitet ligjor shqiptar ku forma ligjore e përzgjedhur do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
2. Forma ligjore e shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me parashikimet e ligjit shqiptar dhe statutit.
3. Shoqëria holding do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutit të nënshkruara ndërmjet ortakëve të shoqërisë, marrëveshjet e mundshme nënshkruara mes Ortakëve dhe Pronarëve përfitues si dhe legjislacionit shqiptar.
4. Në rast se parashikimet e këtij Akti Themelimi dhe Statuti bien në kundërshtim me ato të marrëveshjeve mes palëve/ortakëve, parashikimet e këtyre marrëveshjeve do të kenë përparësi.

**NENI 3
SELIA E SHOQËRISË, ZYRA QENDRORE**

1. Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në adresën më poshtë përshkruar : Tiranë, Rruga "Komuna e Parisit" me zone kadastrale nr. 8260 me nr. Pasurie 6/251-N6. Shoqëria mund të hap zyra përfaqësimi ose degë të tjera të saj Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

**NENI 4
KOHËZGJATJA**

1. Shoqëria "HD HOLDING SH.P.K", do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj që prej momentit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Binesit, për një periudhe kohore të papercaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo lloj shkaku të ligjshëm.

Drilon Gashi

Drilon Gashi

KREU II OBJEKTI

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

1. Shoqëria është organizuar si shoqëri holding, me qëllim zotërimin e pjesëmarrjeve (kuotave dhe aksioneve) të saj, si dhe/ose të ortakëve të saj, në shoqëri të tjera brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë "HD Holding" sh.p.k , përfshin por nuk kufizohet si mëposhtë :
 - Themelimi, krijimi, administrimi i shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja si dhe pjesëmarrja në to nëpërmjet përfutimit të kuotave dhe aksioneve të zotëruara nga ortakët në shoqëri ekzistuese dhe/ose të themeluara rishtazi nga vetë Shoqëria dhe/ose ortakët;
 - Ofrimin e garancive, shërbimeve të menaxhimit si dhe konsulencës organizative, teknike, financiare, tregtare, kontabël, të marketingut, ligjore, etj., për grupet, shoqëritë e kontrolluara.
 - Blerja apo disponimi mbi pjesëmarrjen e kapitalit në shoqëri, partneritete me objekt aktiviteti të ndryshëm, blerja dhe shitja e aksioneve dhe kuotave apo pjesëmarrje të tjera në sipërmarrje dhe shoqëri, brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni i aplikueshëm;
 - Këshillimin të vazhdueshëm teknik, financiar, tregtar, manaxherial, kontabël dhe ligjor, në kuadër të veprimtarive si blerja, hipotekimi, zhvillimi, shitja dhe dhënia me qera e pasurive të paluajtshme. Investime në fushën e ndërtimit dhe tregëtimit brenda dhe jashtë vendit të pasurive të paluajtshme. Menaxhimin dhe administrim pronash dhe objekteve. Dhënie me qera, nën qira të ambjenteve të ndryshme. Organizimi i eventeve, publikimeve, reklama dhe fushata reklamuese si dhe organizim tjetër përfshir promovimin e pasurive të paluajtshme;
 - Këshillimin të vazhdueshëm teknik, financiar, tregtar, manaxherial, kontabël dhe ligjor, të vazhdueshëm, në kuadër të veprimtarive që shoqëritë e kontrolluara të krijuara rishtazi ose jo do të ushtrojnë përfshirë këtu tregëtim i lëndës drusore, materiale të ngjashme me to me shumicë dhe pakicë, Import-Eksport dhe shitje brenda vendit të drurit të përpunuar dhe/ose stazhionuar, skandinav apo llojeve dhe cilësive të ndryshme sipas % së lagështisë, densitetit, elasticitetit dhe rezistencës ndaj zjarrit duke përfshir CLT, trare, fibër, dru i presuar etj pa u kufizuar vetëm në to, me qëllim montim dhe/ose prodhimin e shtëpive me strukturë druri.
 - Asistencë, mbikëqyrje dhe bashkërendim me shoqëritë e kontrolluara lidhur me përgatitjen, mbajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit organizativ korporativ (përfshirë, por pa u kufizuar, akte themelimi, statute, rregullore, kode sjelljesh/etike, raporte ecurie veprimtarie, vlerësime performace, etj.), asistencë në mbajtjen e librave kontabël, përmbushjen e detyrimeve përkatëse pranë autoriteteve shtetërore, asistencë në përgatitjen e planeve të biznesit, në përpilimin dhe zbatimin e programeve të ristrukturimit, operacioneve ekonomike të zakonshme dhe/ose jashtëzakonshme të shoqërive të kontrolluara (ristrukturime, bashkime, ndarje, zmadhime kapitali, blerje pjesëmarrjesh, likuidim/prishje të shoqërive);
 - Shoqëria mund të kryejë dhe të realizojë çdo aktivitet që lidhet direkt apo indirekt, i cili është si rrjedhim apo ka të bëjë me aktivitetet e renditura më sipër, si dhe mund të ushtrojë çdo lloji aktiviteti tjetër të pashprehur më sipër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shqipëria

Ridvan Selimi

**NENI 6
NDRYSHIME**

1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë emërtimin, selinë si dhe objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

**KREU III
KAPITALI I REGJISTRUAR I SHOQËRISË, KUOTAT DHE ZOTËRIMI I TYRE**

**NENI 7
KAPITALI**

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 100.000 ALL (Një qind mijë lekë) plotësisht I nënshkruar nga ortakët. Shlyerja e kapitalit do të bëhet 30 ditë nga nënshkrimi i këtij akti themelimi dhe statuti.
2. Kapitali i shoqërisë është shlyer nga Ortakët në propocion me pjesën takuese të tyre.
3. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, secila prej tyre me vlerë 50.000 ALL (pesëdhjetë mijë lekë)

**NENI 8
ORTAKËT E SHOQËRISË DHE KUOTAT**

1. Ortakët e shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej tyre në shoqëria përshkruhen si mëposhtë;
 - **Z. Drilon Gashi**, identifikuar me Nr.Personal : 1003973561 dhe Nr I kartës ID : ID1931956. Zotërues i 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
 - **Z. Hazir Gashi**, identifikuar me Nr.Personal : 1251809212 dhe Nr I kartës ID : ID1033049. Zotërues i 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
 - Pranimi I ortakëve të shoqërisë bëhet në përputhje me marrveshjet e shkruara ndërmjetë palëve/ortak dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

**NENI 9
ZVOGËLIMI OSE ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**

1. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.
2. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë mund të relaizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me anë të fitimit.
3. Rritja e Kapitalit do të bëhet me kuota të reja apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese, dhe këto pjesë të reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera a e tyre nominale duhet të shlyhet plotësisht.
4. Zmadhimi I kapitalit nuk do të dobësojë pjesët e interesit të ortakëve në kapitalin e shoqërisë, përveç se kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve, vendim I cili do të merret me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ e votave.
5. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve.

**NENI 10
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

1. Ortakët janë vetëm ata të cilët zotëzojnë kuotat e shoqërisë.
2. Çdo ortak do të ketë të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë në përpjestim me vlerën nominale të kuotës që zotëron. Çdo ortak ka të drejtën për të zgjedhur dhe t'u zgjedhur në organet drejtuese.
3. Çdo ortak ka të drejtën për të marr pjesë në shpërndarjen e fitimeve të shoqërisë.
4. Ortakëve do t'u jepen me kërkesë me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojë dokumentat dhe raportet e shoqërisë.

Shan An

Drilon Gashi

5. Ortakët e shoqërisë mbajnë përgjegjësi vetëm brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë.
6. Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi që tejkalojnë investimet e tyre përkatësisht në kapitalin e shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata realizojnë).

NENI 11 TRANSFERIMI I KUOTAVE

1. Transferimi i kuotave ose pjesëve takuese të ortakëve do të realizohen nëpërmejt shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit dhe çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj dhe/ose marrëveshje mes palëve/ortakë të shoqërisë me formë 'Akt Noterial' për efekt vlefshmërie.
2. Asnjë ortak nuk mund të vendosë mbi kuotat asnjë barrë të çfarëdolloj natyre qoftë, përfshirë, por pa u kufizuar, peng, garanci, barrë siguruese, etj., dhe/ose t'i vendosë si objekt i një të drejte për t'i barrësuar pa marrë më parë miratimin me shkrim të asamblesë së Përgjithshme të ortakëve. Asnjë ortak nuk do të bëhet palë në asnjë marrëveshjeje në lidhje me të drejtën e votës që lidhet me të gjithë apo një pjesë të kuotës së tij.
3. Në rast se një ortak dëshiron të shesë, transferojë apo të disponojë kuotën e tij në përputhje me nën-pikat e këtij neni:
 - a) ortaku në fjalë do të paguajë të gjitha huatë, kreditë, detyrimet për të cilat ai i detyrohet shoqërisë (bashke me çdo interes dhe/ose kamatëvonesë të akumuluar);
 - b) ortakët e tjerë do të sigurohen që Shoqëria do të paguajë të gjithë huatë, kreditë, detyrimet për të cilat Shoqëria i detyrohet ortakut ofrues (bashkë me çdo interes dhe/ose kamatëvonesë të akumuluar).
4. Çdo transferim i kryer në kundërshtim me rregullat dhe kufizimet e këtij neni 11 do të konsiderohet i pavlefshëm dhe ortaku ofrues do të jetë përgjegjës ndaj ortakëve të tjerë dhe Shoqërisë për dëmin e shkaktuar
5. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
6. Në çdo rast kalimi i kuotave, realizohet me miratimin dhe dhënien e pëlqimit të shoqërisë ose duke respektuar gjithmon të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

KREU IV ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 12 KUORUMI

1. Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është organi drejtues i shoqërisë e cila merr vendime mbi aktivitetin e shoqërisë.
2. Ortakët bien dakort se e drejta e votes në Asamblenë e Përgjithshme do të jetë në propocion me zotërimin e kuotave nga secili Ortak. Secili ortak ka të drejtë të propozojë çështje që do të përfshihen në rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 13 MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga legjislacioni ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
2. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas përcaktimeve ligjore ose statutore.
4. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Shumë

Dudë

6. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
7. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

NENI 14

MËNYRA E MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
3. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës dhe rezultatet e votimit.
4. Procesverbalit nënshkruhet nga ortakët pjesëmarrës në mbledhje;
5. Procesverbalit i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 15

MARRJA E VENDIMEVE NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet si më poshtë përshkruar:
 - përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - përcaktimin e emrit të markës dhe dizajnit;
 - ndryshimet e statutit;
 - emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
2. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

KREU V ADMINISTRATORËT

NENI 16 ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

1. Asambleja e përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë.
2. Administratori i shoqërisë është një person fizik i çdo lloj kombësie dhe nuk është e nevojshme të jetë resident në Shqipëri.

Shqipëria

Dudan Shqipëria

3. Administratori mund të jetë një prej ortakëve të shoqërisë ose një person tjetër i jashtëm i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve i cili ushtron detyrën e tij mbi një kontratë pune nënshkruar mes palëve.
4. Administratori i shoqërisë është:

Z. Hazir Gashi, shtetas Kosovar, i ditëlindjes 01/01/1988, lindur në Kosovë dhe banues në Kopliq i Poshtëm, Skënderaj, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Nr.Personal : 1251809212 dhe Nr I kartës ID : ID1033049.

5. Administratori do të emërohet për një afat 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
6. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
 - kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - përfaqësoj shoqërinë tregtare;
 - kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
7. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
8. Administratori kryen detyrat e përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
9. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, është I detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

KREU VI ADMINISTRIMI FINANCIAR I SHOQËISË

NENI 17 EKSPERT KONTABËL I AUTORIZUAR

1. Ortakët mund të caktojnë ekspertin kontabël të autorizuar për t'i shërbyer shoqërisë.
2. Ekspertët mund të kryejnë funksinet audituese në përputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII AKTIVITETI I SHOQËISË

NENI 18 VITI EKONOMIKO-FINANCIAR

1. Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Jhor Am

Drilbon Selim

NENI 19
MBAJTJA E LLOGARIVE

1. Shoqëria do të mbajë llogari në lekë dhe në monedhë të huaj.

NENI 20
VULA

1. Shoqëria do të ketë vulën e saj.
2. Vula duhet të figurojë në të gjithë shkresat zyrtare të shoqërisë që dalin në dhe për llogari të saj.

NENI 21
LLLOGARITJA DHE SHPËRNDARJA E FITIMIT

1. Fitimi I shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me statuin, marrëveshjet mes palëve dhe ligjit në fuqi.
2. Nga fitimet vjetore do të caktohet një fond reserve.
3. Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek ortakët vetëm nëse pa kësaj shpërndarje
 - Asetet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e shoqërisë
 - Shoqëria ka active likuide te mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme Brenda 12 muajve të ardhshëm.
4. Administratoret lëshojnë një çertifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat më sipër.

KREU VIII
PRISHJA E SHOQËRISË

NENI 22
PRISHJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria do të mbyllet dhe aktiviteti i saj tregtare do të përfundojë sipas parashikimeve përshkruar më poshtë:
 - Një vendim i asamblesë së përgjithshme marrë për këtë qëllim;
 - Me vendim gjykate;
 - Për arsye të tjera të përshkruara në çdo kohë nga ortakët e shoqërisë.
2. Administratori regjistron vendimin për prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, përveç rastit kur vendimi është marrë nga gjykata dhe kjo e fundit njofton vendimin për regjistrim QKB-së.

NENI 23
LARGIMI I ORTAKUT NGA SHOQËRISË

1. Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:
 - me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
 - me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
 - përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
3. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.
4. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Harin Lami

Orin Shani

5. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.
6. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

NENI 24
LIKUJDIMI I SHOQËRISË

1. Likujdimi i shoqërisë do të bëhet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar për rastin e likujdimit.
2. Kur shoqëria kalon në procedurën e likujdimit Asambleja cakton komisionin e likujdimit I cili paraqet pasqyrat e bilancit të likujdimit dhe shoqëria mbyll aktivitetin e saj në momentin që ky bilanc aprovohet.
3. Pasuria e shoqërisë, pasi shlyen detyrimet e shoqërisë, I kalojnë ortakëve të shoqërisë, sipas kapitalit themeltar.
4. Likuidatori është përgjegjës si ndaj shoqërisë edhe të tretëve dhe shpërblehet mbi bazen e vendimit të asamblesë.

NENI 25
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponoheshë në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 26
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përsa nuk është shprehur në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtar dhe shoqëri tregëtare" si dhe çdo dispozitë e legjislacionit shqiptar që ka rol rregullator në këtë mardhënie juridike tregëtare.

NENI 27
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Shoqëria fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë.

ORTAKËT E SHOQËRISË "HD HOLDING SH.P.K" :

ADMINISTRATOR/ORTAK

Z. Hazir Gashi *Hazir Gashi*
HAZIR GASHI

ORTAK

Z. Drilon Gashi *Drilon Gashi*
DRILON GASHI